



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 68 prot.

Kamëz, më 19.05.2022

V E N D I M

Nr. 58.Datë 19/05 2022
MBI

“MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË LISTËN E VENDIMIT NR.97 DATË 10.11.2021 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DS4 “PËR SHEMBJE” DHE MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR.94 DATË 10.11.2021 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DS4 “PËR RIKONSTRUKSION”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.05.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.55 Datë 18.05.2022 Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” Urdhërit nr. 479 datë 22.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në Njësinë Administrative Paskuqan për dosjet e administruara sipas urdherit nr.456 datë 10.09.2021”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve përfitues të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.97, datë 10.11.2021 së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt-ekspertiza e thelluar e institutit të ndërtimit DS4 **“Për shembje”**
2. Miratimin e një shtese në listën e subjekteve përfitues të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.94, datë 10.11.2021 së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt-ekspertiza e thelluar e institutit të ndërtimit DS4 **“Për rikonstruktion”**
3. Listën e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 (një) të këtij vendimi, paraqitet në anksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
4. Lista e subjekteve shtesë të përcaktuar në pikën 2 (dy) të këtij vendimi, paraqitet në anksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI